Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Nr: 02-3779/4
03.11.2026
Shkup

PROCESVERBAL
nga seanca e 35-të e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele të mbajtur me datë 21.10.2026

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë:

- **Kryetari i Këshillit:** Mr. Sasho Stefanovski
- **Zëvendëse e kryetarit të Këshillit:** Mr. Zirjeta Jajaga
- **Anëtarët e Këshillit:** Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, mr. Gordana Majnova, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavllovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /.

Të pranishëm nga drejtuesit e Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Dr.Zoran Trajçevski, drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe Muhamer Beqiri, zëvendësi i drejtorit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, Emilija Janevska, Ruzhica B. Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 35-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 10:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 7 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 34-ët e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 20.10.2026.
2. Propozim për inicimin e procedurës kundërvajtëse për shkelje të heshtjes zgjedhore - Zgjedhjet Lokale 2026.
3. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Propozim-procesverbalin nga seanca e 34-ët e Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur me datë 20.10.2026.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, dr. Zoran Trajçevski, informoi se Ndërmarrja Publike Radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), gjatë heshtjes zgjedhore në Zgjedhjet Lokale në Bërvenicë 2026, më 17 dhe 18 tetor, transmetoi katër herë përmbajtje në të cilat përfaqësoheshin bartës të funksioneve publike dhe atë - zëvendësministër, kryetar bashkie, deputet aktual dhe ish-kryeministër. Ai theksoi se përmbajtja u transmetua për një kohë të konsiderueshme, gjë që shkel Kodin Zgjedhor.

Në bazë të nenit 76-b, paragrafi (3) i Kodit Zgjedhor, Drejtori propozoi që Këshilli i Agjencisë të inicoi procedurë kundërvajtëse kundër Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1).

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi Mbikëqyrjen e kryer (monitorim) mbi prezantimin mediatik zgjedhor, nr.10-3781/1 të datës 20.10.2026, të Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup - Televizioni i Maqedonisë, Shërbimi i parë programor (RTM1). Për shkelje të nenit 76-b, paragrafi (3), dhe në lidhje me nenin 69-a, paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor, Këshilli njëzëri konkludoi të inicoi procedurë kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente kundër Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë - Televizioni i Maqedonisë, Shërbimi i parë programor (RTM1).

Sektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës kompetente kundër Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive Radiotelevizioni i Maqedonisë Shkup - Televizioni i Maqedonisë, Shërbimi i parë programor (RTM1).

Pas votimit, Drejtori i Agjencisë tregoi se Propozim-procesverbali nga seanca e mëparshme nuk u ishte dorëzuar anëtarëve të Këshillit. Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, tregoi se Propozim-procesverbali nuk përmbahej në materialet e paraqitura dhe theksoi se ai do të shqyrtohej dhe do të hidhej në votim në vazhdimin e seancës së 35-të.

Pika 3

Nën pikën "Të ndryshme" nuk kishte diskutim.

Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshilli,
mr. Sasho Strefanovski